



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Cabinet of the Ministry/Kabinet Ministra/

Numër: 484/018
Datë: 29/10/2019

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L - 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare, nr. 7 / 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 dhe nenit 20 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 1.4 të Udhëzimit administrativ nr.14/2017 për ndarjen e bursave nxjerr:

V E N D I M

1. Përcaktohen fushat e studimit për ndarjen e bursave për institucionet publike të arsimit të lartë për studentë për vitin akademik 2019/2020 për nivelet e studimit Bachelor dhe Master si në vijim:
 - 1.1. Bujqësi – Veterinari;
 - 1.2. FShMN;
 - 1.3. Mjekësi e përgjithshme, Farmaci dhe Stomatologji;
 - 1.4. Teknik;
 - 1.5. Shkenca të aplikuara;
2. Nota mesatare e studentëve për fitimin e bursës për fushat e përcaktuara në pikën 1, nënparagrafeve 1.1, 1.2,1.3,1.5 të këtij vendimi, duhet të jetë së paku 9.0, ndërsa për pikën 1.4 duhet të jetë së paku 8.0.
3. Kushtet dhe kriteret për bursa për student me aftësi të kufizuara zbatohen sipas UA Nr.14/2017.
4. Obligohet Departamenti i arsimit të lartë të shpall konkursin për bursa për vitin akademik 2019/2020, sipas këtij vendimi, dhe të ndjek procedurat e nevojshme për ndarjen e bursave.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ofron bursa duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë nr.04//L-037, prioritetet nacionale dhe interesat strategjike të vendit që synojnë arritjen e objektivave të arsimit të lartë, mbështetjen e studentëve me bursa studimi për studentët e shkëlqyer në programet e studimit në fusha prioritare, studentët me aftësi të kufizuara. Bazuar në nevojën për fuqizim dhe ngritje të kapaciteteve në fushën e shkencave teknike për zhvillimin ekonomik të vendit dhe në mungesë të kuadrave në këtë fushë, është ulur kriteri i notës mesatare vetëm nga lëmia e shkencave teknike.

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Ministrit;
2. Sekretarit të përgjithshëm;
3. Arkivit.

